

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE
“DACI AND ASSOCIATES” SH.P.K.

Në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe ligjit nr.55/2018, datë 23.7.2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, nënshkruesi i këtij dokumenti, vendosi si më poshtë vijon:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Baza ligjore

1. Hartimi i Aktit të Themelimit dhe Statutit bazohet dhe respekton kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, ligjit nr.55/2018 datë 23.7.2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, dhe legjislacionit civil në fuqi.
2. Dispozitat e Statutit kanë karakter të detyrueshëm dhe rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërisë me Ortakun e Vetëm dhe organet e saj. Çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë dokument, rregullohen sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit shqiptar.

Neni 2
Përkufizime

1. Në këtë dokument, nëse nuk përcaktohet ndryshe, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:
 - 1) **“Shoqëria”** nënkupton shoqërinë tregtare të themeluar sipas këtij dokumenti, me emrin e përcaktuar në nenin 4 të këtij Statuti dhe të ndryshuar sipas rastit, në përputhje me kërkesat e Statutit dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi.
 - 2) **"Statuti"** nënkupton statutin e Shoqërisë.
 - 3) **"Ortak(ët)"** Sipas rastit, themeluesit e Shoqërisë ose personat fizikë dhe/ose

juridikë që zotërojnë kuotat e Shoqërisë në përputhje me kërkesat e këtij Statuti.

4) **"Person"** është çdo person fizik apo juridik.

2. Në këtë Statut, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës përkatëse rezulton ndryshe, shprehjet në numrin njëjës përfshijnë ato në numrin shumës dhe anasjelltas, dhe gjinia mashkullore përfshin edhe atë femërore dhe anasjelltas.

Neni 3 Komunikimet

1. Të gjitha njoftimet dhe/ose komunikime që Shoqëria i drejton Ortakëve sipas këtij Statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen Ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit (ëve) të Shoqërisë duke përfshirë dhe komunikimet me mjete elektronike nëse këto të fundit garantojnë konfirmimin e marrjes dhe sigurinë e komunikimit.
2. Të gjitha njoftimet dhe/ose komunikimet e dërguara sipas paragrafit të mësipërm, do të konsiderohen rregullisht të marra nga Ortaku në datën më të hershme midis: (i) datës së marrjes efektive nga Ortaku, (ii) datës së pranimi apo refuzimit të shënuar në njoftimin e marrjes nëse dërgohet me postë të regjistruar; ose (iii) brenda 72 orësh nga dorëzimi pranë një shërbimi të shpejtë postar të njohur ndërkombëtarisht.

KAPITULLI II

THEMELIMI

Neni 4 Data e themelimit, Themeluesit dhe Emri

1. Sot, më datë **8.1.2024**, Ortaku i Vetëm, krijon një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.
2. Emri i shoqërisë është **“DACI AND ASSOCIATES” SH.P.K.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me emrin **DACI AND ASSOCIATES SH.P.K.** (*këtu e në vijim: "Shoqëria"*). Ndryshimi i emërimit të Shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
3. Themeluesi dhe Ortaku i Vetëm i shoqërisë është: Av. Prof. Asoc. Dr. Jordan DACI, i biri i Fatos dhe i Dashurisë, i datëlindjes 18.02.1980, lindur në Sllovë, Dibër dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 034417273 dhe me Nr. Personal I00218159N; Tel: 04 220 2402 ose +355 69 40 10 577; e-mail: jordan.daci@gmail.com.

4. Themeluesi i shoqërisë deklaron me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, pranimin e dispozitave dhe parashikimeve që vijnë, hartimin e Akt themelimit -Statutit të shoqërisë "**DACI AND ASSOCIATES**" SH.P.K mbi bazën e ligjit nr. 9901 të datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, ligjit nr.55/2018 datë 23.7.2018 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë", dhe harton këtë Statut si vijon:

KREU II

SELIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, DEGËT DHE ZYRAT E PËRFAQËSIMIT, PËRGJEGJËSIA E ORTAKËVE

Neni 5 Selia

1. Selia e Shoqërisë është në adresën: "Rr. "*Dervish Hima*", Kompleksi 3 kullat; pranë stadiumit "*Air Albania*", Kulla 1, Kati 11, Tiranë.
2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë, si dhe mund të vendosë hapjen e degëve dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Shoqëria gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin, brenda ose jashtë territorit të saj.

Neni 6 Objekti i Shoqërisë

1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar si studio avokatie duke ofruar këto shërbime:
 - 1) këshillimit ligjor të personave fizikë dhe juridikë;
 - 2) përfaqësimit në procesin penal, civil, administrativ, ose të ndonjë natyre tjetër që mund të mospërfshihet në këto tri kategori, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare ose çdo organizmi tjetër, pranë të cilit Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe përfaqësimit në procedurat e ndërmjetësimit ose të arbitrazhit;
 - 3) hartimit të akteve juridike dhe çdo akti tjetër, sipas kërkesave të personave fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - 4) veprimeve të tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar ose në legjislacionin e huaj, kur veprimtaria kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - 5) çdo veprimtari tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Shoqëria mund të lidh marrëveshje bashkëpunimi me zyra ligjore të tjera kombëtare dhe/ose ndërkombëtare në përmbushje të objektit të veprimtarisë.
3. Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë llogari rrjedhëse në lekë apo valuta të tjera, pranë bankave shqiptare apo të huaja, duke disponuar lirisht mjetet monetare të akumuluar në to, konform legjislacionit në fuqi.
4. Shoqëria mund të ndryshojë objektin e saj të aktivitetit në çdo kohë, në përputhje me dispozitat e Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare dhe këtij Statuti.

Neni 7 **Kohëzgjatja e Shoqërisë**

1. Kohëzgjatja e Shoqërisë fillon nga momenti i regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe është pa afat të caktuar.
2. Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga momenti regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKB) Tiranë.

Neni 8 **Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm**

1. Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është person që ka përfituar kuotën e tij në Shoqëri në përputhje me kontributin e tij. Ortaku i Vetëm nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tij.

KREU III

KAPITALI I REGJISTRUAR DHE KUOTAT, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT, KALIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT

Neni 9 **Kapitali i Shoqërisë**

1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është i barabartë me 100.000 (njëqindmijë) lekë i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga Ortaku i Vetëm. Kapitali themeltar është i përbërë nga një(1) kuotë e cila i përket, Ortakut të Vetëm, z. Jordan Daci.
2. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar, nga pasuri të luajtshme ose të pa luajtshme dhe nga pasuri të tjera të dhëna ose që do të jepen të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të Shoqërisë.

Neni 10
Zmadhimi i Kapitalit të Regjistruar

1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë mund të zmadhohet pa kufi, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 11
Zvogëlimi i Kapitalit të Regjistruar

1. Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e regjistruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin e kërkuar nga ligji.

Neni 12

Fitimet e Shoqërisë i takojnë Ortakut të Vetëm. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose riqarkullimin e tyre, duke përcaktuar edhe mënyrat.

KREU IV

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13
Asambleja e Përgjithshme

Në bazë të ligjeve shqiptare dhe dispozitave të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Ajo përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj, të marra në përputhje me ligjin dhe këtë Statut, janë detyruese për të gjithë ortakët.

Neni 14
Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm përgjegjës për marrjen e vendimeve për Shoqërinë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe këtë statut, veçanërisht në lidhje me çështjet e mëposhtme:
 - 1) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - 2) ndryshimet e statutit;
 - 3) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - 4) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- 5) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
 - 6) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - 7) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - 8) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - 9) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - 10) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - 11) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - 12) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
 - 13) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - 14) anulimin e kuotave;
 - 15) largimin ose përjashtimin e ortakut;
 - 16) ndryshimin e logos të shoqërisë, markat tregtare;
 - 17) çështje të tjera të parashikuara nga ligji nr. 9901/2008 date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligji nr.55/2018 datë 23.7.2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, apo nga ky statut.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
 3. Administratori i Shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.
 4. Administratori i shoqërisë zgjidhet dhe shkarkohet me 2/3 e votave të të gjithë ortakëve të shoqërisë.
 5. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 15

Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar nga administratori drejt ortakëve me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Adresa elektronike e-mail e ortakëve regjistrohet në dokumentet e Shoqërisë.

Neni 16

Vendimmarrja dhe kuorumi

1. Vendimet e asamblesë së përgjithshme merren në formën e vendimeve me shkrim.

Neni 17

Procesverbali i Mbledhjes

1. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali përmban datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e Kryetarit të Mbledhjes, emrin e Mbajtësit të Procesverbalit, rezultatet e votimit.

Neni 18

Administratori

1. Administratori është organi ekzekutiv i Shoqërisë.
2. Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.
3. Administratori ka të drejtë të kryejë administrimin e zakonshëm të Shoqërisë. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë pranë çdo organi shtetëror si dhe në marrëdhënie me të tretët; të hartojë dhe të nënshkruajë çdo dokument të nevojshëm lidhur me mbarëvajtjen e aktivitetit të Shoqërisë si dhe t'i depozitojë ato pranë çdo organi kompetent shtetëror, apo personave të tretë privatë, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
4. Administratori do të jetë përgjegjës, por pa u kufizuar për sa më poshtë:
 - 1) Të kujdeset për mbarëvajtjen e punëve të përditshme të Shoqërisë, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme lidhur me mbikëqyrjen e personelit; punësimin dhe pushimet nga puna të personelit; dhënien e udhëzimeve lidhur me mënyrën e menaxhimit të punëve në Shoqëri; mbajtjen e korrespondencës së Shoqërisë; dhënien e autorizimit për blerjen, marrjen me qira etj, të mallrave apo shërbimeve të zakonshme të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me punën e përditshme të Shoqërisë; autorizimin për kryerjen e transferimeve bankare apo tërheqjen e shumave të nevojshme nga llogaritë e Shoqërisë lidhur me pagat apo shpërblimet e punonjësve të Shoqërisë; Të përpilojë dhe të nënshkruajë faturat tatimore që do të lëshohen në emër të Shoqërisë si rezultat i punëve të kryera; Të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të nënshkruajë çdo dokument për kryerjen e pagesave bankare, depozitime, tërheqje, derdhje, si dhe transferime apo lëvizje të çdo lloji në llogaritë bankare të Shoqërisë, në të gjitha numrat e llogarisë të Shoqërisë, pranë çdo banke ku ndodhen këto llogari,
 - 2) Të përfaqësojë shoqërinë në lidhje me negocimin, hartimin dhe lidhjen e çdo lloj kontrate ose marrëveshje me persona fizikë apo juridikë vendas ose të huaj, me institucione apo ente të ndryshme shtetërore si dhe çdo subjekt tjetër.
 - 3) Të zbatojë vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
 - 4) Të hartojë projekt planin e investimeve të Shoqërisë dhe ta paraqesë për miratim në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve;

- 5) Të caktojë pagat dhe shpërblimet e punonjësve dhe stafit tjetër ndihmës të shoqërisë;
 - 6) Të lidhë marrëveshje me palë të treta bashkëpunimi, investimi apo zhvillimi në funksion të interesit të shoqërisë;
 - 7) Të kryejë investime në interes të shoqërisë;
 - 8) Të vendosë mbi planin operacional të Shoqërisë;
 - 9) Të hartojë buxhetin financiar vjetor për t'u miratuar nga Asambleja e Ortakëve;
 - 10) Ngritjen e sistemit të administrimit të brendshëm;
 - 11) Të emërojë konsulentë të brendshëm e të jashtëm të fushave të ndryshme që i shërbejnë shoqërisë dhe ndihmojnë administratorin në ushtrimin e veprimtarisë të tij;
 - 12) Çdo kompetencë tjetër të parashikuar nga Statuti i Shoqërisë ose ligji.
5. Administratori i parë i shoqërisë është Ortaku i Vetëm: Jordan DACI, i biri i Fatos dhe i Dashurisë, i datëlindjes 18.02.1980, lindur në Sllovë, Dibër dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 034417273 dhe me Nr. Personal I00218159N; Tel: 04 220 2402 ose +355 69 40 10 577; e-mail: jordan.daci@gmail.com.

Neni 19 **Të drejtat e shoqërisë**

Shoqëria ka të drejtë:

- 1) të kryejë veprimtari në bazë të interesave që ka në përputhje me objektin e veprimtarisë;
- 2) të sigurojë pasurinë e vet;
- 3) të marrë kredi në lekë dhe në valutë nga Bankat vendase ose të huaja në bazë të rregullave ligjore;
- 4) të përfitojë nga favoret që i njeh legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe të tjera;
- 5) të investojë kudo në Shqipëri, me të ardhurat që realizon gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj;
- 6) të punësojë punonjës, vendas ose të huaj.
- 7) Çdo të drejtë tjetër që i njeh ligji.

Neni 20 **Detyrat e shoqërisë**

Shoqëria ka për detyrë:

- 1) të sigurojë kapitalin e shoqërisë në formën dhe kohën e duhur;
- 2) të japë garanci për shërbimet që kryen shoqëria;
- 3) të sigurojë punonjësit e saj;
- 4) të plotësojë detyrimet fiskale dhe sociale që ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo;
- 5) të pajiset me leje/autorizime të mundshme, nëse kërkohen nga ligji, për të zbatuar

- objektin e veprimtarisë së saj;
- 6) të respektojë standardet si dhe të gjitha rregullat që lidhen me veprimtarinë e saj.
 - 7) Çdo detyrim tjetër që i njeh ligji.

Neni 21

Marrëdhëniet e punës

1. Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi.
2. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj.
3. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 22

Konfidencialiteti dhe Ruajtja e sekretit

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumenteve që janë përcaktuar si të tilla nga Administratori i Shoqërisë.

KREU V

EKSPERTI KONTABËL, VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 23

Eksperti kontabël

Kur është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilancit financiar dhe i librave të kontabilitetit të Shoqërisë do t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, të emëruar nga Shoqëria.

Neni 24

Viti financiar dhe bilanci vjetor

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.
2. Bilanci vjetor, inventari, raporti i ecurisë së veprimtarisë dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

3. Dokumentet që kanë të bëjnë me ushtrimin e vitit financiar do të miratohen brenda 3 (tre) muajve nga përfundimi i vitit financiar.

Neni 25 **Shpërndarja e fitimeve**

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
2. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve vetëm nëse pas pagimit të dividendëve:
 - 1) aktivet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - 2) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU VI

RIORGANIZIMI I SHOQËRISË, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 26 **Prishja dhe likuidimi i shoqërisë**

1. Shoqëria priset në rastet e parashikuara nga ligji ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast prishje Shoqëria do t'i nënshtrohet procedurës së likuidimit.
2. Për procedurën e likuidimit të Shoqërisë do të aplikohet legjislacioni shqiptar në fuqi.
3. Likuiduesi/t do të emërohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Emërimi i likuiduesit/ëve dhe procesi i likuidimit do të kryhen në përputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

Neni 27 **Dispozita përfundimtare**

1. Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të zbatohet ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, ligji nr. 55/2018 datë 23.7.2018 "Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë", si dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.
2. Ky Akt themelimi-Statut u redaktua në 2 (dy) ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, u miratua në parim dhe nen për nen dhe u nënshkrua nga Oraku i Vetëm në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin origjinal.

ORTAKU I VETËM **Av. Prof. Asoc. Dr. Jordan DACI**